



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr 8145 akti

Tiranë 30.12.2015

V E N D I M

Nr 143 Datë 30/12 /2015

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin
nr. 810/2 prot., datë 03.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**

Në mbështetje të neneve 11, 14, 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe nenit 13, 14 gërma "a" dhe 34, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të administruar dhe relacionit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për punonjësen
***** ,

VËREJ SE

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka marrë dijeni nëpërmjet informacionit të rregjistruar me nr. 810 prot., datë 16.11.2015, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit për punonjësen ***** , deklaruar si nëpunëse civile në Komunën Hajmel, Qarku Shkodër. Për këtë arsye, bazuar në Urdhrin e verifikimit nr.810/2 prot., datë 03.12.2015, ka nisur verifikimi i këtij rasti, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në nxjerrjen e aktit objekt i këtij hetimi administrativ.

Nga materialet e administruara, rezulton se punonjësja ***** ka filluar punë në Komunën Hajmel, me Urdhrin nr. 3, datë 01.09.2013, të drejtuesit të kësaj komune, në pozicionin "Administratore e zyrës së pronave publike dhe aseteve", në Zyrën e Bujqësisë dhe Inspektimit Veterinar, me nivel page IV-a, detyrë të cilën punonjësja e ka kryer edhe në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil".

Më pas, me Vendimin nr. 7, datë 01.07.2014, të Kryetarit të Komunës Hajmel, në kohën kur komunat ishin përfshirë në fushën e shërbimit civil, punonjësja është emëruar në një pozicion tjetër të shërbimit civil, si "Përgjegjëse e Zyrës së Bujqësisë dhe Inspektimit Veteriner", pa respektuar procedurën ligjore të parashikuar në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar) dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e

rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

Më pas, në kuadrin e plotësimit të detyrës ligjore të deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse e Komunës Hajmel, me aktin nr. 347, datë 11.05.2015, ka deklaruar statusin e punësimit për këtë punonjëse si nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin *“Përgjegjëse e Zyrës së Bujqësisë dhe Inspektor Veteriner”*, tej afateve të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë këtë proces.

Nga analiza e dokumentacionit të grumbulluar për inspektimin e rastit, rezulton se ky akt është nxjerrë në zbatim të gabuar të ligjit, për faktin se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, (i ndryshuar), punonjësja ***** , ka qenë e punësuar në pozicionin e punës *“Administratore e zyrës së pronave publike dhe aseteve”*, pozicion në të cilin duhej të ishte bërë edhe deklarimi i statusit të punësimit.

Kalimi në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë dhe inspektimit veteriner”*, me Vendimin nr. 7, datë 01.07.2014, të Kryetarit të Komunës Hajmel, është një veprim administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi nuk është respektuar procedura e rekrutimit e përcaktuar nga ligji nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe si i tillë, në bazë të nenit 117/1, të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të RSH”*, nuk mund të prodhojë pasoja juridike.

Si rrjedhojë e kësaj analize, nëpunësja ***** duhej të përfitonte statusin e nëpunësit civil në periudhë prove, në pozicionin *“Administratore e zyrës së pronave publike dhe aseteve”*, ku ka qenë e punësuar në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Në këto kushte, për rregullimin e ligjshmërisë në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit me nr. 347, datë 11.05.2015, në drejtim të cilësimit të saktë të pozicionit të punës së mbajtur nga punonjësja ***** , nga *“Përgjegjëse e Zyrës së Bujqësisë dhe Inspektimit Veterinar”*, në pozicionin e punës *“Administratore e zyrës së pronave publike dhe aseteve”*.

Në vijim të zhvillimeve që kanë lidhje me reformën territoriale, pas miratimit të ligjit nr.115/2014, *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*, me riorganizimin e njësive të qeverisjes vendore, Komuna Hajmel u bë pjesë e strukturës dhe organikës të Bashkisë Vau Dejës, si Njësi Administrative.

Mbështetur në ligjin nr. 30/2015, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*”, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Vau Dejës, me Vendimin nr. 29, datë 14.08.2015, *“Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës dhe të njësive administrative”*, ka vendosur shkurtimin e pozicioneve të punës në Bashkinë Vau Dejës. Sipas këtij vendimi, Njësia Administrative Hajmel do të pësonte shkurtim të numrit të përgjithshëm të vendeve të punës duke i ulur ato, nga 16 që kishte struktura e mëparshme, në 7 punonjës, prej të cilëve vetëm 5 pozicione pune do të ishin pjesë e shërbimit civil.

Nisur nga ky vendim i Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, bazuar në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, me aktin nr. 490 prot., datë 28.10.2015, ka njoftuar punonjësen mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës. Në vazhdim, me aktin nr. 490/1, dt. 09.11.2015, *“Njoftim”*, punonjësja është vënë në dijeni lidhur me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, për arsye ristrukturimi.

Punonjësja i ka kundërshtuar aktet e mësipërme, me pretendimin se është nëpunëse civile dhe duhej të trajtohej si e tillë gjatë procesit të riorganizimit të njësisë administrative, duke kërkuar për këtë edhe ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Nga hetimi administrativ i kryer vërehet se, trajtimi i kësaj punonjëseje si e emëruar me kontratë pune dhe për pasojë ndërprerja e marrëdhënies së punës mbi këtë bazë, përbën një zbatim të gabuar të ligjit. Punonjësja në fjalë e ka filluar marrëdhënien e punës në Komunën Hajmel në vitin 2013 (me Urdhrin nr. 3, datë 01.09.2013, të Kryetarit të Komunës) pra, para se të fillonin efektet e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në bazë të nenit 67 të tij, ka përfutur statusin e nëpunësit civil në periudhë prove. Për këtë arsye, ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk mund të urdhërohej drejtpërdrejt nga Kryetari i Bashkisë. Në kushtet kur, gjatë procesit të ristrukturimit, ka ndryshim të strukturës së institucionit dhe shkurtim real të pozicioneve ekzistuese, duhej vepruar në mënyrën e përcaktuar në nenin 50, pikat 1, 2 dhe 3, të këtij ligji.

Konkretisht, në bazë të pikës 3, të dispozitës së mësipërme ligjore, duhej ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili do të shqyrtonte mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil, në vendet e lira ekzistuese dhe do të paraqiste propozimet përkatëse për transferim të nëpunësve në pozicione të lira, të mundshme, ku ata plotësojnë kërkesat specifike.

Vetëm nëse është objektivisht i pamundur sistemimi i të gjithë punonjësve ekzistues, për shkak se pozicioni i punës nuk ekziston më, apo të mospërshtatjes së pozicionit të mëparshëm në strukturën e re, është njësia përgjegjëse ajo që përpilon aktin e lirim, i cili duhet të shoqërohet me të drejtën për dëmshpërblim, si dhe të drejtën për të konkurruar si nëpunës civil, nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për një periudhë 2 vjeçare.

Në rastin e punonjësës ***** , nuk është respektuar procedura e kërkuar prej nenit 50, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), gjë e cila, në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1, të ligjit nr. 8485, dt.12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative", e bën procesin të cënueshëm nga pikëpamja procedurale dhe të paaftë për të prodhuar pasoja ligjore. Si rrjedhojë, akti nr. 490 prot., dt.28.10.2015, "Mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës", të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, si dhe akti nr. 490/1 prot., dt. 09.11.2015, "Për zgjidhjen e kontratës së punës", janë akte absolutisht të pavlefshme, për shkak të mosrespektimit të procedurës ligjore dhe si të tillë, duhet të revokohen.

Për këto arsye

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe nenin 35, të Rregullores "Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", të miratuar me Vendimin nr.17, dt.11.03.2015

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, rregullimin e ligjshmërisë duke vepruar si më poshtë:
 - a. Të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 347, datë 11.05.2015, duke cilësuar saktë pozicionin e punës të mbajtur nga punonjësja ***** në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil (datë 26.02.2014), nga "Përgjegjëse e Zyrës së Bujqësisë dhe Inspektimit Veterinar", në pozicionin

“Administratore e zyrës së pronave publike dhe asetëve”, si nepunëse civile në periudhë prove;

- b. Të revokojë aktet administrative nr.490 prot., datë 28.10.2015, *”Mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës”*, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës dhe nr. 490/1 prot., datë 09.11.2015, *”Për zgjidhjen e kontratës së punës”*, dalë në vazhdim të aktit të mësipërm, për shkak të shkeljes së rëndë të procedurës të kërkuar nga ligji, në nxjerrjen e tyre.
2. Të kryhet procesi i ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Vau Dejës, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe kryerjen e të gjithë procesit, duke respektuar kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin Civil”*, i ndryshuar; kreut III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*.
3. Në rastin e pamundësisë të sistemimit të punonjësve që u është shkurtuar ose ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke u njohur atyre, përfitimet që rrjedhin prej pikave 7 dhe 8 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin Civil”*, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe dy vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, të cilat lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje dhe arsye të tjera të ligjshme.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë vendimin duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.
5. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e vendimit.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Vau Dejës dhe punonjësja ***** .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA